



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në

“Mami ”

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Vjollca Durro

Prof. Etleva Refatllari

Janar / 2024

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Mami” zhvillohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore të Fakultetit të Studimeve Profesionale në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, hapur me UMASH Nr. 213, datë 31.05.2013, “Për hapjen e disa programeve të studimeve në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) është një institucion publik i arsimit të lartë i liçencuar me VKM Nr. 801, datë 20.12.2005. UAMD është akredituar në vitin 2017 dhe riakredituar në vitin 2022 me VBA nr. 18, datë 24.03.2022.

UAMD përbëhet nga 5 fakultete: Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Fakulteti i Biznesit dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, politike, edukimit, IT dhe mjekësore. Fakulteti i Studimeve Profesionale përbëhet nga katër departamente:

1. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore;
2. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës;
3. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë;
4. Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën;

Programi i studimit Bachelor në “Mami” zhvillohet në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore (DSHTM) të Fakultetit të Studimeve Profesionale (FSP). Në këtë departament zhvillohen 5 (pesë) programe studimi: 3 (tre) programe studimi në Bachelor, një Master Profesional dhe një program profesional jouniversitar.

Programi i studimit Bachelor në “Mami” është hapur me Urdhër Nr. 213, datë 31.05.2013 të MASH. Ky program është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për Arsimin e Lartë, përshtatjen e programit me Vendim Senati Nr. 95, datë 14.06.2018 miratuar nga MASR me shkresë Nr 7239/1 prot., datë 17.08.2018.

Programi i studimit Bachelor në “Mami” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e institucionit, Ligjin 80/2015 për “Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet ligjore në fuqi për IAL. Ai është i organizuar në 3 (tre) vite akademike me 180 kredite, 6 (gjashtë) semestra, me kohë të plotë. Në fund të programit të studimit studenti pajiset me diplomë të ciklit të parë Bachelor në “Mami”.

- Vizita në UAMD e zhvilluar në datat 06.06.2023 dhe 07.06. 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UAMD. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Mami”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) është institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me VKM nr. 801, datë 20.12.2005. UAMD ka marrë akreditimin institucional për një periudhë 4 vjeçare me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 18, Datë 24.03.2022.</p> <p>UAMD është qendër universitare e rëndësishme për rajonin që përgatit profesionistë të fushave të ndryshme në përputhje me interesat e zhvillimit kombëtar. UAMD bën përpjekje të vazhdueshme që përmes ofrimit të dijeve në nivele bashkëkohore të ruaj dhe të konsolidojë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. UAMD organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në statutin e UAMD theksohet se arsimi i lartë është i mirë dhe përgjegjësi publike dhe në këtë kontekst, neni 3 i statutit parashtron misionin e UAMD formimin e specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj për përmbushjen e kërkesave të tregut shqiptar dhe ndërkombëtar të punës. UAMD fokusohet në mënyrë të veçantë në arsimin universitar të integruar me praktikën profesionale. Në statut theksohet se programet dhe projektet shkencore bazohen në fushat prioritare të zhvillimit kombëtar dhe mbështesin interesat strategjike të vendit. Programet e studimit të ofruara nga UAMD janë në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Kombëtar të Arsimit të Lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe teknologjisë. Programet e ofruara nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore janë në përputhje me strategjinë kombëtare për shëndetësinë që synon ndër të tjera shtimin e numrit dhe cilësisë së personelit shëndetësor për</p>



	(Evidencat 1-Mendimi i Dekanit, 4-Statuti i UAMD, 6-Plani i zhvillimit strategjik 2020-2025, takimet në institucion)
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>UAMD dhe FSP e bazojnë veprimtarinë e tyre në Statutin dhe rregulloret e institucionit. Mbështetur në këto dokumenta bazë të funksionimit të institucionit hartohen rregulloret e programeve të studimit. Në përbërje të Fakultetit të Studimeve Profesionale janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe të Natyrës; 2. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore; 3. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë; 4. Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën; <p>Programi i studimit Bachelor në “Mami” është hapur për herë të parë me Urdhër Nr. 213, datë 31.05.2013 të MASH, dhe riorganizuar me Vendim nr 95, datë 14.06.2018 të Senatit Akademik, aprovuar me Shkresë MASR nr.7239/1prot., datë 17.08.2018.</p> <p>Në rregulloren e DSHTM theksohet se programet e ciklit të parë të studimeve që ofron ky departament synojnë të japin njohuri bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi të caktuara në një larmi të gjerë profesionesh dhe specialitetesh. Programi i studimit Bachelor në “Mami” synon formimin e profesionistëve të aftë të veprojnë në autonomi profesionale në fushën e shëndetit të gruas në institucione spitalore, në sistemin ambulator si dhe të mund të ofrojnë kontribut në promovimin e shëndetit në popullatë. Programi i studimit iu krijon mundësinë studentëve jo vetëm për punësim por dhe për vijimin e studimeve dhe kërkim shkencor. Për të siguruar rritje të cilësisë dhe konkureshmërisë së programeve të studimit, UAMD kë përpiluar dhe Dokumentin e Planifikimit të Veprimtarive Strategjike 2021-2023 që vendos objektiva dhe ofron mundësi objektive monitorimi të aktivitetit në fushat e përcaktuara si fusha strategjike për sigurimin e cilësisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programet e studimit 2. Kërkimi shkencor 3. Ndërkombëtarizimi 4. Burimet njerëzore 5. Studenti dhe shërbimet




	<p>6 në Durrës, disa klinika private si dhe me Urdhërin e Infermierëve të Shqipërisë.</p> <p>(Evidencat 81;122-CV e stafit akademik, 121 Dosja e Programit të studimit, Tabelat 1, 2, 5 dhe 16 të RVB)</p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Mami” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Fakulteti i Studimeve Profesionale në UAMD. FSP përbëhet nga katër departamente dhe ofron 16 programe studimi me karakter profesional; 4 programe Bachelor, 2 programe Master Profesional dhe 10 programe 2 vjeçare.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ofron programet e studimit: <ul style="list-style-type: none"> • Bachelor <ul style="list-style-type: none"> ○ Infermieri e përgjithshme ○ Fizioterapi ○ Mami • Master Profesional <ul style="list-style-type: none"> ○ Infermieri kirurgjikale • Program 2 vjeçar <ul style="list-style-type: none"> ○ Asistencë dentare 2. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Natyrës ofron programet e studimit: <ul style="list-style-type: none"> • Program 2 vjeçar <ul style="list-style-type: none"> ○ Asistent administrativ ○ Asistent ligjor ○ Informatikë praktike ○ Specialist rrjetesh kompiuterike 3. Departamenti i Shkencave Inxhinierike dhe Detarisë ofron programet e studimit: <ul style="list-style-type: none"> • Bachelor <ul style="list-style-type: none"> ○ Navigacion dhe Menaxhim Detar • Master Profesional <ul style="list-style-type: none"> ○ Logjistikë dhe siguri detare • Program 2 vjeçar <ul style="list-style-type: none"> ○ Teknik elektrik ○ Teknologji automobilash ○ Menaxhim transporti detar dhe tokësor ○ Menaxhim ndërtimi ○ Hidroteknikë ujësjellës kanalizime 4. Departamenti i Studimeve të Integruara me Praktikën

	<p><i>gjinekologjik në sistemin spitalor dhe ambulator. Programi synon të përgatisë studentët me kapacitete të mjaftueshme teoriko-praktike për të vazhduar studime të mëtejshme dhe kërkim shkencor. Programi është në përputhje me strategjinë kombëtare në fushën e shëndetësisë dhe synon të përmbushë nevojat specifike për personel mami.</i></p> <p><i>FSP dhe DSHTM kanë përvojë, kapacitete akademike dhe infrastrukturore të mjaftueshme për të realizuar këtë program studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Mami” të ofruar nga DSHTM janë përfshirë PAE dhe PAK, staf ndihmës akademik dhe administrativ i UAMD (referencë standarti 1/kriteri 4). Organizimi i strukturave realizuese të programit është piramidial dhe funksionon me parimin e bashkëpunimit dhe kontrollit. Kompetencat dhe detyrat e strukturave akademike, ndihmës akademike dhe administrative janë parashikuar në Statutin dhe Rregulloret e Institucionit. Në RVB deklarohet se DSHTM bashkëpunon me Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve, Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, Drejtorinë e Planifikimit, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorinë e Administrimit Financiar për zgjidhje të detyrave administrative dhe akademike. Komunikimi zyrtar midis tyre bazohet në rregullore. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi një frymë pozitive bashkëpunimi midis këtyre strukturave.</p>
	<p>GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit. Për të siguruar</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 13

	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesmarrje në projekte kryesisht për ngritjen e kapaciteteve; • Realizimin e konferencave; <p>Në raportin vjetor të janë paraqitur në mënyrë të detajuar marrëveshjet, mobiliteti i stafit dhe studentëve si dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të marrëveshjeve.</p> <p>(Evidencat 34-Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD, 36-Mobilitetet e UAMD(staf dhe studentë), 38.1-Projekti Erasmus, 38.2-Mobiliteti Ceepus, 96-Tabela e marrëveshjeve të bashkëpunimit FSP, 94-Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit DSHTM, 64-Raporti vjetor UAMD).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>FSP ka nënshkruar 12 marrëveshje bashkëpunimi me institucione kombëtare me qëllim kryerjen e praktikave profesionale, por edhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta ku mund të angazhohen studentët e mamisë, por edhe të cikleve të tjera të studimeve. Referuar tabelës 5 të ASCAL marrëveshjet e mëposhtme funksionojnë specifikisht për kryerjen e praktikave profesionale të programit të studimit Bachelor në “Mami”.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Marrëveshja e bashkëpunimit me Spitalin Rajonal Durrës 2. Marrëveshjet e bashkëpunimit me Qendrat Shëndetësore Nr.1 dhe Nr.6 në Durrës 3. Marrëveshja e bashkëpunimit me “Auxila Academie” 4. Marrëveshja e bashkëpunimit me “Hungarian Hospice-Palliative Association” 5. Marrëveshja e bashkëpunimit me kompaninë Edar Medical 6. Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e infermierëve të Shqipërisë <p>Në takimin me stafin u informuam se shumica e praktikave realizohen pranë spitalit rajonal të Durrësit. Viti i parë e bën praktikën në qendrën e gruas ose në urgjencë. Viti i dytë dhe i tretë kalojnë në sallat e lindjes për praktikë. Gjatë periudhës së pandemisë Covid19 institucioni përpiloi një rregullore specifike funksionimi për të realizuar programin mësimor edhe për pjesën praktike spitalore. Koordinator i programit të studimit Bachelor “Mami”, çdo vit akademik pasqyron nëpërmjet raporteve analitike ecurinë e praktikave profesionale me institucionet e bashkëpunimit. Koordinator</p>

	(Evidencat 64-Raporti vjetor UAMD, 126-Raporti analitik me institucionet e bashkëpunimit)			
Konkluzione	<p><i>GVJ mbështetur në analizën e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe konstatimeve nga takimet në institucion gjykon se standardi I.2 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shëndetësore lokale përmes të cilave siguron realizimin e praktikave klinike për studentët e këtij programi studimi me qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e infermieristikës dhe të mamisë aftë për të shërbyer në komunitet në parandalim, kurim edukim shëndetësor etj.</i></p> <p><i>Institucioni ka lidhur një numër të madh marrëveshjes me institucione universitare europiane që i shërbejnë jo vetëm aftësimin profesional të stafit por janë dhe në funksion të kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në	Programi i studimit Bachelor në “Mami” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe tabelave të RVB:

	<ul style="list-style-type: none"> Programi i studimit mbyllet me provim ose temë diplome. Në rregulloren e programit të studimit theksohet se “Në bazë të kriterit të notës mesatare dhe/ose kriteret e tjera, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar”. Në takimin me stafin akademik dhe GVB u informuam se kufiri i notës mesatare që studenti të diplomohet me temë diplome është 7.5. <p>(Evidencat 10 – Rregullore e programit të studimit, 121 – Dosja e programit të studimit, 123/124 – Syllabuset, Tabelat e ASCAL, Takimi me stafin akademik dhe GVB)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në dokumentin “Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020 – 2025” paraqiten vizioni dhe misioni i UAMD. Në dokument theksohet se “Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore, si një realitet i ri dhe dinamik duke ofruar një alternativë serioze në panoramën e Arsimit të Lartë. Misioni i Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, është të rrisë prestigjin dhe të sjellë shkencë dhe punësim, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit. Programet e studimit të ofruara janë bashkëkohore, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, pasi përcaktimi i fushave prioritare të studimit janë të identifikuar në interes të zhvillimit rajonal e kombëtar.”</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Mami” synon formimin e specialistëve kompetentë në fushën e asistimit obstetrik gjinekologjik. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Ata marrin njohuri për menaxhimin dhe organizimin e pavioneve të obstetrikës, gjinekologjisë, patologjisë së shtatzanësisë, për punën në sallën operatore. Njohuritë e marra gjatë tre viteve të studimit shërbejnë si bazë e mirë për të ofruar shërbim në qendrat e shëndetit të gruas apo në kushte të urgjencës mjekësore në fushën e obstetrikë – gjinekologjisë. Kurrikula e programit të studimit ofron përgatitje teoriko-praktike të gjerë në fushën e infermierisë dhe mamisë. Lëndët e formimit bazë mjekësor (Anatomi, Fiziologji, Biokimi, Histologji, Mikrobiologji Shëndet Publik dhe Higjenë etj.) dhe formimit të përgjithshëm (Sociologji-Psikologji, Latinisht, Dietologji, Menaxhim Shëndetësor etj.) janë pjesë e programit në vitin e parë të studimit dhe pjesërisht në vitin e dytë. Në vitin e</p>

	<p>2. Kategoria B: Lëndë karakterizuese 100 ECTS ose 55.56% (standardi 50 – 55%)</p> <p>3. Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 22 ECTS ose 12.2% (standardi 12 – 15%)</p> <p>4. Kategoria D: Lëndë plotësuese 24 ECTS ose 13.3% (standardi 10 – 15%)</p> <p>5. Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 5 ECTS ose 2.8% (standardi 3 – 5%)</p> <p>(Evidencat 121 – Dosja e programit të studimit, Tabelat 9,10 të ASCAL)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Mami” ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Në planin mësimor konstatohet se praktika profesionale shpërndahet në mënyrë pothuaj proporcionale në të tre vitet e studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin e parë 7 ECTS • Në vitin e dytë 6 ECTS • Në vitin e tretë 7 ECTS <p>Në seksionin I (nenet 24, 25, 26, 27) dhe seksionin III (nenet 38, 40, 41) të rregullores së programit të studimit përcaktohen qartë kushtet e diplomimit, mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm si dhe mënyra e organizimit të mbrojtjes së temës së diplomës. Në seksionin II të rregullores janë përkrahur rregullat e përgjithshme mbi temën e diplomës (udhëheqësi, zgjedhja e temës, përmbytja/struktura, miratimi, rregullat e shkrimit). Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ka përpiluar gjithashtu një rregullore të detajuar për shkrimin e mikrotezës së diplomës. Në planin mësimor përcaktohen 5 ECTS për detyrimet përmbyllëse.</p> <p>(Evidencat 10 – Rregullore e programit të studimit, 96 – Rregullore e mikrotezës, Tabelat 9, 10 të ASCAL)</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe</p>	<p>Në kreun VI të statutit të UAMD dhe kreun III të Rregullores përcaktohet qartë që pranimi dhe regjistrimi i studentëve në programet e studimit të bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati në përputhje me standartet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukurore që verifikohen dhe çertifikohen nga ministria përgjegjëse përpara deklaratimit të kuotave nga universiteti. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloret e programeve të studimit përcaktohet forma e organizimit të studimeve. Programi</p>

publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	studimi është kryer dhe kodifikimi i lëndëve i cili pasqyrohet në dokumentat e planit mësimor. (Evidencat 26 – Tabela e kodifikimit të programeve në UAMD, 119 – Urdhër regjistrimi i formës së diplomës së programit Mami, RVB, Plani mësimor)			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Kriteri nuk aplikohet. Programi i studimit nuk ofrohet si program i përbashkët.			
Konkluzione	<p>GVJ gjykon se standarti II.1 përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Programi i studimit Bachelor në “Mami” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin dhe rregulloren e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të shërbimit shëndetësor komunitar përmes ofrimit të ekspertizës në fushën Mami. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Pranimi, regjistrimi i studentëve dhe financimi në programet e studimit të UAMD bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati.</i></p> <p><i>Programi është i kodifikuar dhe krijon mundësi për mobilitet dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



	<p>Në realizimin e programit të studimit Bachelor “Mami” institucioni ka përfshirë:</p> <p>Në vitin 2020 – 2021:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 14 PAE (1 Prof., 8 Dr., 1 Dr. në proçes, 5 Msc) – 16 PAK (2 Dr., 1 Dr. në proçes, 13 Msc.) <p>Në vitin 2021 – 2022:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 14 PAE (1 Prof., 2 Prof. Asc., 7 Dr., 1 Dr. në proçes, 3 Msc.) – 18 PAK (3 Dr., 15 Msc.) <p>Në vitin 2022 – 2023:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 13 PAE (3 Prof. Asc., 8 Dr., 2 Msc.) – 15 PAK (1 Dr., 14 Msc.) <p>PAK janë personel të angazhuar me kohë të plotë në institucionet mjekësore (Qendra spitalore apo shëndetësore) ku studentët kryejnë aktivitetin e praktikave profesionale.</p> <p>Lidhur me treguesit e moshës rreth 80% e stafit akademik të përfshirë në mësimdhëniei përkasin grup moshës 25 – 45 vjeç. Nga analiza e të dhënave të tabelave vërehet qëndrueshmëri e stafit PAE në tre vitet e fundit dhe tendencë për rritje në kualifikim. Nga analiza e tabelave mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezulton se 42% e ngarkesës mësimore të programit të studimit Bachelor në “Mami” përballohet nga PAE.</p> <p><i>GVJ rekomandon shtimin e numrit të stafit PAE në përputhje me rekomandimet ligjore.</i></p> <p>(Evidencat 4 – Statuti i UAMD, 56 – Organiograma e FSP, tabelat e ASCAL, CV e personelit akademik)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik/ administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>FSP dhe DSHTM kanë angazhuar në këtë program studimi dhe 2 staf ndihmës akademik (Msc), laborantë që asistojnë studentët në realizimin e punëve laboratorike dhe praktikave në mjediset e institucionit.</p> <p>Në funksion të programit të studimit janë dhe personeli administrative dhe ndihmës teknik. Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe teknik dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione punë.</p> <p><i>(Tabelat e RVB, takimet në institucion)</i></p>

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FSP dhe DSHTM në UAMD që ofrojnë programin e studimit Bachelor në “Mami” disponojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion kemi gjetur informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, të dhëna për infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementin e diplomës. Në RVB theksohet se dokumentacioni ruhet i protokolluar pranë njësisë kryesore. Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. Në takimin me stafin dhe drejtuesit e institucionit u informuam për përfshirjen aktive të stafit në përgatitjen e RVB dhe hartimin e dokumentacionit bazë dhe mbështetës për procesin e akreditimit.</p> <p>(Evidencat 121 – Dosja e programit të studimit, Takimet në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Mami” është i organizuar në lëndë /module dhe praktikë mësimore në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore).</p> <p>Për secilën lëndë jepet informacion i detajuar për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual. Jepet gjithashtu informacion për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte dhe praktika. GVJ gjykon se raportet e veprimtarive formuese në auditor janë të arsyetuara sipas tipologjisë së lëndës. Plani mësimor hartohet nga njësia bazë dhe miratohet nga Dekanati i FSP dhe Senati i UAMD.</p> <p>(Evidencat Tabelat 9, 10 të ASCAL, Plani mësimor)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe</p>	<p>Në statutin dhe rregulloren e UAMD përcaktohet qartë që pranimit dhe regjistrimi i studentëve në programet e studimit bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati në përputhje me standartet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore që</p>

	<p>Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. GVJ konstatoi se të dhënat e literaturës në syllabuse nuk janë të plota, në një pjesë prej tyre mungojnë vitet e publikimit. GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar dhe ndihmëse.</p> <p>(Evidencat 123/124 – Syllabuset, CV e personelit akademik)</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi Bachelor në “Mami” është organizuar sipas kërkesave të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” (i përditësuar). GVJ konstaton se programet e studimit në UAMD janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në department dhe pranë zyrës së kurikulave dhe cilësisë çdo fillim viti. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse të mundësuar dhe nga investimet në mjete audiovizive në auditorë si dhe investimet në laboratorë.</p> <p>(Evidencat 121 – Dosja e programit të studimit, 123/124 – Syllabuset, takimi me stafin në institucion)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se standardi II.3 përmbushet kryesisht.</p> <p><i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. GVJ konstatoi se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – <i>titullarët e lëndëve (me pak përjashtime) nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore.</i> – <i>në disa syllabuse lënda nuk përputhet me fushën e ekspertizës së titullarit të lëndës. (për detaje referencë Standardi4; Kriteri2) GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve sipas formimit profesional të pedagogëve.</i> – <i>të dhënat e literaturës në syllabuse nuk janë të plota, në një pjesë prej tyre mungojnë vitet e publikimit. GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar dhe ndihmëse.</i>

	<p>Programi ka një shpërndarje të llogjikshme të lëndëve në vite dhe semestra si dhe vlerësim në kredite sipas rëndësisë së syllabusit në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës në orë mësimore /ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme.</p> <p>(Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit)</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit Bachelor në "Mami", emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën disa vjeçare të ofrimit të këtij programi nga UAMD si dhe mbështetur në modelet dhe praktikatat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë.</p> <p>Zyra e Alumni ka komunikim me agjensitë e njohjes së diplomave brenda vendit dhe jashtë (publike në Itali apo private në Gjermani dhe Angli). Nga verifikimi që kjo njësi ka bërë është konstatuar që rreth 75% e kurrikulës përputhet me tregun european. Ka njohje të shpejtë të diplomave në Gjermani. Italia kërkon më shumë praktikë.</p> <p>(Evidenca Nr.121 Dosja e programit te studimit, takimet në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit është në funksion të përmbushjes së objektivave kryesore formuese të tij që janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e studentëve në menaxhimin dhe organizimin e pavionit të obstetrikës, gjinekologjisë dhe patologjisë së shtatzanisë. 2. Aftësimi dhe familjarizimi i studentëve me sallën operatore dhe teknikat antiseptike në pavionet gjinekologjike dhe obstetrikale. 3. Zhvillimi i aftësive për t'u njohur dhe për të punuar në pavionet e gjinekologji-obstetrikës. 4. Përgatitja për të ofruar shërbimet parësore pranë qendrave të shëndetit të gruas si dhe pavionit të urgjencës, bashkëngjitur pavioneve të mësipërme. <p>Strukturimi i programit, unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurrues në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Në takimet me zyrën e këshillimit të karrierës GVJ u informua se studentët e këtij programi studimi kanë mundur të transferojnë studime ose të</p>

	(Evidencat 121 – Dosja e programit të studimit, Takimet në institucion)		
Konkluzione	<p>GVJ gjykon se Standardi II.4 përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit Bachelor në “Mami” synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Mami” ka pësuar përmirësime për t’u përshtatur me ndryshimet e legjislativës, kërkesat e tregut të punës dhe strategjitë kombëtare për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe të shëndetësisë. UAMD ka një procedurë të detajuar për ndryshime/përmirësime në kurrikulën e programit që përshkruhet në detaje në RVB. Çdo sugjerim/propozim i ardhur nga lektorët, studentët apo aktorët e tjerë të përfshirë në realizimin e programit (kryesisht institucionet mjekësore) vlerësohen fillimisht nga njësi bazë dhe me tej ndjekin rrugën hierarkike për aprovim nga senati i universitetit. Proçesi organizohet dhe drejtohet nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë.</p> <p>Në takimet me drejtuesit e institucionit dhe personelin akademik GVJ u informua se përmes analizave dhe debatit shkencor në nivel Departamenti dhe Fakulteti diskutohen dhe aplikohen ndryshimet përmirësuese të programeve me kontributin e</p>

Konkluzione	<p>GVJ gjykon se standardi II.5 përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Institucioni ka krijuar kushte për përmirësim dhe përditësim të programeve të studimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe kërkesat e tregut të punës. Në parim, UAMD nxit dhe përfshin në diskutime studentët të cilët janë të përfaqësuar në senatin akademik dhe NJSBC. Studentët kanë gjithashtu organizimin e tyre në formën e Këshillit studentor.</i></p> <p><i>Në përmirësimin e përditësimin e programit të studimit japin kontributin e tyre dhe rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve, mjekë të specialitetit me eksperiencë si dhe përfaqësues të institucioneve me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura	Në rregulloren e FSP përshkruhen format e mësimdhënies, mësimnxënies e transmetimit të njohurive në këtë cikël studimi. Për zhvillimin e procesit mësimor në programin e studimit Bachelor në “Mami” është parashikuar përdorimi i metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, laboratorë, praktika profesionale e klinike, përgatitja e detyrave të kursit, tema diplome, punë kërkimore në laborator, dhe/ose në institucione spitalore me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi. Në takimin me studentët u informuam se institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca (me punime të kryera në bashkëpunim me

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 35

	<p>mësimi interaktiv që kombinon shpjegimin me pyetjet për subjektin e shpjeguar apo ushtrimet në lidhje me të. Stafit akademik i brendshëm dhe i jashtëm që jep mësim në programin e studimit Bachelor në “Mami” është i hapur drejt formave të aplikimit dhe metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, si ndërthurja e teorisë me praktikën në ambientet e Spitalit Rajonal Durrës dhe në laboratorin e mamisë. Format e ndryshme të mësimdhënies sanksionohen dhe në rregulloren e FSP. Në syllabuse gjithashtu, konform rekomandimeve ligjore temat mësimore ndahen sipas formave të mësimdhënies.</p> <p>(Evidencat 8 – Rregullore e FSP, 10 – Rregullore programit të studimit, 136 – Grafiku i praktikave profesionale, Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Fakulteti i Studimeve Profesionale, në funksion të përmirësimit të kompetencave didaktike dhe të aplikimit të formave bashkëkohore të mësimdhënies ka investuar në teknologji të reja për të rritur mundësinë që orë të caktuara mësimore apo tema leksioni të caktuara të mund të zhvillohen në mënyrë më aplikative. Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët e kirurgjisë, infermierisë, mamisë dhe fizioterapisë.</p> <p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. Periudha e pandemisë ishte një sfidë për mësimdhënien por që rezultoi e realizuar me sukses. Personeli IT i institucionit realizoi trajnime dhe përgatiti dokumenta trajnues për aftësimin e personelit akademik në mësimdhënien online.</p> <p>(Evidencat 101 – Struktura dhe foto laboratorëve, 45 – Politika të zhvillimit të stafit akademik, Vizita dhe takimet në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 2, 4, 6.1, 6.2, GVJ konstatoi se i gjithë stafi</p>

<p>mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>formave të mësimdhënies janë dhe leksionet e hapura, shkëmbimet e eksperiencave midis pedagogëve, leksionet me ekspertë të ftuar me eksperiencë akademike në fushën e programit të studimit.</p> <p>(Evidenca nr. 106 Formulari i vlerësimit të lektorëve nga studentët, Takimet dhe vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, institucioni ka ngritur struktura specifike që koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësitë bazë dhe kryesore. Ngritja e këtyre strukturave sanksionohet në statutin e UAMD. Ato janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria e Auditimit të Brendshëm - Drejtoria e Burimeve Njerëzore - Drejtoria e Projekteve dhe e Marrëdhënieve me Jashtë - Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (NJSBC) - Qendra për Kërkim dhe Ekselencë - Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetar <p>Rolin më të rëndësishëm në monitorimin dhe përmirësimin e mësimdhënies e luan NJSBC dhe koordinatorët e programeve pranë njësisë bazë. Drejtoria e kurrikulës ka dy sektorë, sektorin mësimor dhe sektorin e sigurimit të cilësisë. Sektorët mbulojnë të gjithë problematikat e programeve nga licënsimi në akreditim.</p> <p>Stafi i ri me Msc trajnohet për mësimdhënie nga Qendra e Edukimit në Vazhdim. Një rol të rëndësishëm në trajnimin e stafit luajnë dhe leksionet e hapura me personalitete të fushës në Shqipëri por edhe nga universitete jashtë Shqipërisë. Institucioni vlerëson arritjet e stafit akademik dhe i prezanton në analizat e departamentit dhe fakultetit. Për promovimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve institucioni organizon aktivitete e konferenca me bashkëpunimin e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë. Në takimet me stafin akademik u konstatua fryma pozitive e institucionit në raport me bashkëveprimin hierarkik dhe horizontal në nivel njësie qendrore dhe njësie bazë.</p> <p>(Evidencat 4 – Statuti UAMD, 11 – Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, 45 – Politika të zhvillimit të stafik akademik, 139 – Ceopus Interinstitution Agreements, 43 – Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve).</p>

<p>me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloret e funksionimit të Fakultetit, dhe programit të studimit. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Të dhënat për mënyrën e vlerësimit janë pasqyruar në tabelën 15 të RVB.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejta për të hyrë në provim (neni 18) • Proçedura e zhvillimit të provimeve (neni 19) • Rregullat e provimit (neni 20) • Ankimimi i provimeve (neni 21) <p>(Evidencat 5 – Rregullore e UAMD-së, 10 – Rregullore e programit të studimit, Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, provimi diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Sistemi i vlerësimit është i pikëzuar. Nota maksimale kërkon grumbullimin e 1000 pikëve në total nga të tre format e vlerësimit të cituara në kriterin 1 të këtij standardi. Nota kaluese minimale arrihet kur studentit grumbullon 505 pikë nga të tre mënyrat e vlerësimit.</p> <p>(Evidencat 5 – Rregullore e UAMD-së, 10 – Rregullore e programit të studimit, Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i metodave të mësimdhënies mbetet prioritet i DSHTM ku zhvillohet ky program studimi. Mendimi i studentëve reflektohet në analizat e pyetsorëve të studentëve për lëndët, pedagogët dhe infrastrukturën. Në takimet me stafin dhe NJSBC u konstatua se institucioni ka reflektim për kërkesat dhe sugjerimet e studentëve. Një shëmbull ishte riorganizimi i orëve të funksionimit të bibliotekës sipas kërkesës së studentëve.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në përmirësimin e metodave të mësimdhënies luan trajnimi i pedagogëve Msc nga Qendra e Edukimit në Vazhdim. Gjatë periudhës së pandemisë një kontribut të rëndësishëm në realizimin e mësimdhënies dhe vlerësimit të studentëve ka dhënë dhe personeli IT që ka trajnuar pedagogët për përdorimin e platformave on line dhe metodave alternative të mësimin dhe vlerësimit.</p>

	<i>përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentit realizohet përgjatë gjithë vitit akademik në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, në tabelat e RVB dhe syllabuse përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 40% e pikëve (400 pikë) të notës fitohen nga provimi i ndërmjetëm • 10% e pikëve (100 pikë) të notës fitohen nga plotësimi i detyrimeve detyra kursi/projekte • 50 % e pikëve (500 pikë) të notës fitohen nga provimi përfundimtar. <p>Studenti vlerësohet kalues nëse grumbullon të paktën 505 pikë. Vlerësimi maksimal është 1000 pikë.</p> <p>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në bazë të rregullores së departamentit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari lëndës/pedagogu.</p> <p>(Evidencat 5 – Rregullore e UAMD-së, 8 – Rregullore e FSP, 10 – Rregullore programit të studimit, Syllabuset).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në UAMD zbatohet prej disa vitesh sistemi i automatizuar i korigjimit të provimeve në sajë të projektit CLEANSCORE. Për të familjarizuar anëtarët e stafit akademik me çështjet teknike që do të nevojiten gjatë zbatimit të procesit, institucioni morri masa për të kualifikuar një pjesë të stafit akademik (3 anëtarë të DSHTM). Nëse testimi me shkrim përmban dhe pyetje shtjelluese teorike veç pyetjeve me alternativa korigjimi i provimit është i kombinuar: skaner optik për pyetjet me</p>

	<p>provim. Në këtë mënyrë studentët përmirësojnë mësimnxënien për në provimin pasardhës.</p> <p>(Evidencat 5 – Rregullore e UAMD, 8 – Rregullore e FSP, 10 – Rregullore e programit të studimit)</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>UAMD ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Në rregulloret e institucionit dhe në kodin e etikës pasqyrohen penalitete për rastet e kopjimit apo plagjiaturës. Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë, komunikimi midis studentëve, prania e personave të paautorizuar. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Nëse pedagogu konstaton shkelje të këtyre rregullave, studenti përjashtohet nga provimi.</p> <p>Në lidhje me plagjiaturën, secili lektor ka nga një databasë të vetën me detyrat e kursit/projektet e dorëzuara ndër vite dhe e kontrollon nëse materiali është i kopjuar ose jo nëpërmjet softeve. Temat e diplomave dorëzohen në Hard Copy dhe CD e cila i kalon seksionit të IT që verifikon materialin për plagjiaturë para hedhjes në sistem. Në të gjitha rastet kur evidentohet plagjiaturë, detyra e kursit/projekti ose diploma anulohet. Rregullorja e UAMD parashikon masa të forta kundrejt studentëve që kryejnë shkeljet e mësipërme që fillojnë nga verejtja verbale (dekani) deri tek pezullimi i studimeve për periodha të caktuara apo heqja e të drejtës së studimit.</p> <p>(Evidenca 5 – Rregullore e UAMD-së)</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda 3 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistem. Në rregulloret e institucionit dhe RVB theksohet se një notë e raportuar mund të ndryshojë vetëm nëse rezultoni së është bërë një gabim gjatë hedhjes në sistem. Lektori duhet të bëjë një kërkesë në sistem drejtuar dekanatit dhe</p>

	<p>nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës;</p> <p>7. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëherë ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;</p> <p>(Evidencat 5 – Rregullore e UAMD, 8 – Rregullore e FSP, 10 – Rregullore e programit të studimit)</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ gjykon se standardi III.3 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndeve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin Pitagora ESSE3. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. UAMD ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë	Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Mamisë. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim bazë në lëndët paraklinike, klinike si dhe

<p>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/ çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>komunikimit dhe ndërveprimit/legjislacionit. Programi i studimit Bachelor në “Mami” ndër kompetencat e tij liston diskutimin, interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme gjinekologjike-obstetrikale. Detyrat e kursit pasi prezantohen në klasë (qofshin individuale apo punë në grup) nxisin diskutime nga gjithë klasa dhe shtrohen zgjidhje praktike apo edhe sfida që pritet të marrin një përgjigje në të ardhmen.</p> <p>Por janë edhe disa lëndë, të cilat pasi merret teorikisht informacioni, testimi i këtyre njohurive praktike kalon në laboratorin e mamisë (Infermieristika Obstetrikale, Infermieristika Gjinekologjike). Gjithashtu, studentët futen edhe në laboratorin e kirurgjisë (Anestezi Reanimacionit, Kirurgji).</p> <p>Për punën individuale apo në grup, për detyrat e kursit, studentët përdorin sallën e kompjuterave (laboratori IT-së)</p> <p>Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët janë përfshirë në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme.</p> <p>(Evidenca 121 – Dosja e programit të studimit, Vizita dhe takimet në institucion)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Mami” integron të rejtat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë në informacionin që u jep studentëve gjatë zhvillimit të programit mësimor si dhe në leksione të hapura, tavolina të rumbullakta jashtë strukturës së programit mësimor. Në të tilla aktivitete ftohen dhe mjekë nga institucione shëndetësorë apo institucione arsimore vëndase dhe të huaj që ndajnë eksperiencat dhe arritjet e tyre.</p> <p>FSP dhe DSHTM organizojnë zhvillimin e një konference vjetore ndërkombëtare, ndërdisiplinore ku marrin pjesë me punimet e tyre staf akademik i UAMD dhe personalitete të ftuar. Ky aktivitet ka dhe një sesion të veçantë për studentët të cilët inkurajohen të prezantojnë punimet e kryera nën udhëheqjen e pedagogëve. DSHTM organizon dhe konferenca studentore. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve.</p> <p>(Evidencat 73 – Raport mbi aktivitetet kulturore, shkencore, artistike, 73.1 – Memo për organizimin e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 49

<p>për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>studentët që përmbyllin detyrimet me mesatare mbi 7.5. Ky informacion bëhet publik për studentët. Rregullorja e punimit të temës së diplomës (mikrotezës) mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës dhe formatit të saj, zgjedhjen e udhëheqësit dhe përgjegjësitë e tij, kriteret e vlerësimit dhe parimet etike.</p> <p>(Evidencat 5 – Rregullore e UAMD-së, 8 – Rregullore e FSP, 10 – Rregullore programit të studimit, 97 - Rregullore Mikrotezës FSP).</p>
<p>Kriteri 2.Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Njësia Bazë asiston studentët duke vënë në dispozicion të tyre të gjitha informacionet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së temës së diplomës/mikrotezës. Në rregulloren e mikrotezës theksohet se udhëheqësi shkencor ka përgjegjësi të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi ka përgjegjësinë gjithashtu të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës. Pedagogët i orientojnë studentët dhe iu japin informacion lidhur me materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzojnë. Për provimin final, lista e lëndëve me përqindjet përkatëse që do jenë pjesë e pyetjeve në provim afishohet të paktën 3 muaj para mbarimit të programit të studimit. Teza e provimit final hartohet vetëm me pyetje QUIZ.</p> <p>(Evidencat 97 – Rregullore Mikrotezës FSP, 141 – Kopje e tezës së diplomimit)</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit. Njësia Bazë propozon komisionin e diplomimit që miratohet nga Njësia qendrore. Komisioni përgatit në total 4 teza me pyetje të mbyllur me qarkim, të cilat depozitohen tek Njësia Bazë bashkë me çelësat. Ditën e provimit tezat shumëfishohen dhe shpërndahen për të vazhduar provimin e diplomimit. Vlerësimi për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit bëhet nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga DSHTM dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë të DSHTM. Nota përfundimtare</p>

<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Realizimi i temës së diplomës bazohet në rregulloren që departamenti ka përpiluar në mënyrë specifike për mbrojtjen e diplomës. Institucioni i siguron studentëve infrastrukturën e nevojshme logjistike për realizimi e studimit. Studentët mbledhin të dhënat në strukturat shëndetësore ku realizohet studimi ose realizojnë pjesën eksperimentale në laboratorët e infermierisë dhe kirurgjisë. Nga ana tjetër bibliotekat e ngritura pranë FSP-së janë të hapura edhe gjatë fundjavës dhe ofrojnë literaturë dhe mjedise të mjaftueshme që studentët të punojnë për punimet e temave të diplomave/mikrotezave.</p> <p>(Evidencat 8 – Rregullore FSP, 55 – Kalendar i Bibliotekës në fundjavë, 101 – Lista e laboratorëve).</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të studimeve të ciklit Bachelor, studenti mund të diplomohet me temë diplome ose me tezë provimi.</p> <p>Nëse ai diplomohet me temë diplome, ai dorëzon dy kopje të punimit të diplomës/mikrotezës të miratuara nga udhëheqësi shkencor si edhe një CD. Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga DSHTM dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë. Mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij, në jo më pak se 20 minuta. Vlerësimi i temës së diplomës/mikrotezës bëhet me sistem 1000 pikësh i cili konvertohet në notë në sistemin shqiptar. Rezultatet e mbrojtjes së temës së diplomës/mikrotezës u bëhen me dije studentëve në fund të ditës.</p> <p>Në rastin e studentëve që mbarojnë programin e studimit me provim final, komisioni për hartimin e pyetjeve të provimit, i ngritur nga Njësia Bazë dhe i aprovuar nga Njësia Kryesore, harton pyetjet e provimit 1 javë para provimit.</p> <p>Gjithashtu, një komision korrigjimi ngrihet nga Njësia Bazë dhe aprovohet nga Njësia Kryesore.</p> <p>Në RVB theksohet se komisioni korrigjon tezat brenda ditës dhe nxjerr rezultatet e provimit final po atë ditë (në rregullore afati maksimal është 72 orë).</p> <p>(Evidencat RVB, 10 – Rregullore e programit të studimit, 97 – Rregullore Mikrotezës FSP)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës,</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.</p>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Departamenti përgjigjës i programit të studimit është Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore. Në tre vitet akademike 2021-2022 përbërja e stafit akademik është si vijon:</p> <p>Për vitin 2020 -2021 Stafi akademik përbëhet nga 67(gjashtëdhjetëeshtatë) staf akademik, prej të cilëve 15 (pesëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 52(pesëdhjetëedy) PAE. Nga PAE 9(nëntë) janë Doktorë shkencash dhe 6(gjashtë) Msc. Nga PAK 2(dy) janë të kategorisë Profesor, 10 (dhjetë) janë me gradën Doktorë shkencash dhe 40(dyzetë) Msc. Në përbërje të Departamentin janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me Msc.</p> <p>Për vitin 2021-2022 Stafi akademik përbëhet nga 68(gjashtëdhjetetetë) staf akademik, prej të cilëve 15 (pesëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 53(pesëdhjetetre) PAE. Nga PAE 9(nëntë) janë Doktorë Shkencash dhe 6(gjashtë) janë Msc. Nga PAK 3(tre) janë të kategorisë Profesor, 11(njëmbëdhjetë) janë me gradën Doktorë Shkencash dhe 39(tridhjetenëntë) Msc. Në përbërje të Departamentit janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me Msc.</p> <p>Për vitin 2022-2023 Stafi akademik përbëhet nga 65 (gjashtëdhjetepesë) staf akademik, prej të cilëve 16 (gjashtëmbëdhjetë) janë personel akademik me kohë të plotë dhe 49 (dyzetenëntë) PAE. Nga PAE 10(dhjetë) janë Doktorë Shkencash dhe 6 (gjashtë) janë Msc. Nga PAK 1(një) është i kategorisë Profesor, 11 (njëmbëdhjetë) janë me gradën Doktorë Shkencash dhe 36 (tridhjetëegjashtë) janë Msc. Në përbërje të Departamentin janë dhe 2(dy) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me Msc.</p>

	<p>Në tre vitet e fundit vihet re që numri i stafit akademik është stabël dhe ka rritje të cilësisë të stafit akademik të ftuar.</p> <p>(Evidence Tabelat ASCAL dega bachelor Mami., Evidenca Nr.122 CV e stafit akademik te jashtem te programit te studimit. Evidenca Nr.81 CV te Stafit Akademik dhe Ndhimes Akademik te DSHTM.)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e programit Bachelor në “Mami” , janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Pjesë e stafit të programin është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor me formimin e duhur profesional, cili është përgjegjës për organizmin e praktikave mësimore dhe asiston pedagogët në realizimin e tyre si dhe studentët në praktikimin e procedurave të ndryshme. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësimor në këtë program studimi, formimi i tyre profesional, për tre vitet akademike 2020-2023.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit Bsc. Mami është si vijon :</p> <p>Stafi akademik ka formimin dhe edukimin e duhur profesional për realizimin e programit mësimor.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacion mbi Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se ka pedagog që japin lëndë që nuk përputhen me formimin tyre profesional/specialitetin. P.sh. staf me formim biolog zhvillojnë module në lëndë laboratorike mjekësore specifike si mikrobiologji mjekësore, staf me formim biokimi -biologji zhvillon biokimi mjekësore.</i></p> <p>Referuar evidencës mbi ngarkesën mësimore të stafit akademik konstatojmë se pjesa më e madhe e ngarkesës mësimore mbi 70% realizohet nga stafi akademik efektiv. <i>Raporti PAE/PAK është 16/49 duke mos qenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</i></p> <p>Mosha e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit është relativisht e re dhe pjesa më e madhe e stafit akademik është në grup moshën 36-55vjeç.</p> <p><i>GVJ bazuar në konstatimet e mësipërme rekomandon:</i></p>

1. Formulari i aplikimit (ose kërkesë për riaplikim)
2. Diploma e studimeve
3. Liçenca e ushtrimit të profesionit
4. Karta e identitetit
5. Vërtetim nga fakulteti
6. Çertifikata trajnimesh dhe pjesëmarrje në konferenca
7. Rekomandim

Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuara nga UAMD dhe kodin e punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Bazuar në statusin e UAMD dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedurë dhe kriteret për rekrutimin e personelit. Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit, ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe atë vjetore. Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevojë për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik për realizimin e programit të studimit, dekanati i përcjellë në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat.

Pasi miratohen në senat vendet e lira të punës shpallen në faqen e WEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga kandidati, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit të kandidatit. Pas shpalljes së vendit vakant, dekani ngre komision "ad hoc" që do të realizojë procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurrimi kalon në dy faza:

1. Vlerësim në bazë të dosjes
2. Intervista gojore

Kur një dosje skualifikohet Drejtoria e Burimeve Njerezore lajmëron kandidatin dhe ai brenda afatit kohor prej 5(pesë) ditësh duhet të bëjë ankimim me shkrim nëse ka. Për çdo fazë vlerësimi pritët 5(pesë) ditë pas shpalljes së vlerësimit për ankimime nëse ka. Nëse nuk ka ankimim, mbyllet procedura e vlerësimit dhe vendimi i komisioni i përcillet rektoratit, i cili harton kontratën e punës në bazë të kodit të punës dhe legjilacionit në fuqi. Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim, Institucioni

	<p>(Evidenca Nr.08 Rregullore e Fakultetit të Studimeve Profesionale. Evidenca Nr.09 Rregullore e Departamentit Shkencave Teknike Mjekësore, Evidenca Nr.10 Rregullore e programi te studimit Mami; Evidenca tabelat ASCAL dega bachelor Mami, Evidenca nr. 20 Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit FSHMT UAMD garanton mjedise të mjaftueshme dhe të mirëpajisura brënda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë nënshkruar me këto institucione. Konkretisht GVJ evidentoi që UAMD ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe sic janë Spitali Rajonal Durrës, Qendra Spitalore Univeristare “Nënë Tereza” Tiranë, Qendra Shëndetësore 1 dhe 6 në Durrës, Klinika Edar Medical, Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, Shoqata e Infermirëve të Shqipërisë etj.</p> <p>Marrëveshjet kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale dhe gjithashtu realizimin e diplomës. Marrëveshjet janë të lidhura në nivel Instucional dhe zbatohen nga njësia bazë. Praktika e detyrueshme, mbikëqyret bashkarisht nga mbikëqyesi në vendin e praktikës (një infermiere e dedikuar) dhe anëtari i caktuar i stafit akademik i departamentit.</p> <p>(Evidenca Nr.96 Tabela me Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FSP, Evidenca Nr.135 Grafiku i praktikave spitalore te studenteve, Evidenca Nr.102 Rregullore e laboratoreve. Evidenca Nr.10 Rregullore e programi te studimit Bachelor në Mami.) (Evidenca Nr.94 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të DSHTM)</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të përcaktuar për përcaktimin e udhëheqësve të praktikavë profesionale që përzgjidhen nga drejtuesit e institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marrëveshjeve të lidhura. Praktikave profesionale të programit të studimit Bachelor në “Mami” realizohen në Spitalin Rajonal Durrës dhe janë të shpërndara sipas grafikut të organizuar nga lektori i praktikave në bashkëpunim me përfaqësuesin e Spitalit Rajonal Durrës. Viti i parë e kryhen</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në instucion GVJ u njoh më mjediset e UAMD. Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, zhvillon procesin mësimor në tre godina, një në Currila dhe dy në Kampusin Universitar, Spitalë.</p> <p>Fakulteti i Studimeve Profesionale zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën e Currilave në Godinën Nr. 1, Kampusi Universitar, Spitalë. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin të mirë paisura, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme. Fakulteti i Studimeve Profesionale, ka 18 auditorë me kapacitet total 1316 vende dhe me sipërfaqe totale 1644.5 m², 7 laborator me 352 vende me sipërfaqe 575.6 m², 13 zyra me sipërfaqe totale 362.88 m², sallë konferencash me kapacitet 280 vende dhe me sipërfaqe prej 380 m².</p> <p>Gjithashtu disponon Bibliotekë me sallë leximi me një kapacitet 30 vende me sipërfaqe totale 120 m². Auditorët kanë hapësira të mjaftueshme, të ndriçuara dhe me sistem ngrohje/ftohje. Është në fazën e testimit sistemi ëireless në disa ambiente të Fakultetit të Studimeve Profesionale.</p> <p>Kjo risi krijon kushte të mira për përmirësimin e teknikave të mësimdhënies, ndërkohë që sistemi kabllor i shpërndarjes së internetit është në të gjitha ambientet. Njësia bazë ka në dispozicione mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mesimore. Organizimi i orarit mësimor është bërë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në “Mami” dhe moduleve përkatëse.</p> <p>(Evidenca nr. 42 dhe 42.1 Ambiente të Fakultetit të Studimeve Profesionale)</p>

	<p>me kapacitete ngrohëse e ftohëse gjatë gjithë vitit. Ato janë funksionale gjithmonë</p> <p>Në dispozicion të studenteve të programit studimit Bachelor në “Mami” janë dhe Laboratorët në varësi të departanenteve të tjera të FSP. (Evidenca nr. 101 Foto të laboratorëve, Evidenca nr. 102 Rregullore e laboratoreve)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në funksion të programit të studimit në Bachelor në “Mami” është laborator i teknologjisë së Informacionit. Laboratori është i pajisur me kompjutera dhe programe profesionale për që përdoren nga studentët pa pagesë për qëllim mësimi apo përgatitje të detyrave të kursit dhe/ose mikrotezës.</p> <p>Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor dhe me mundësi për të aksesuar sistemin wireless të internetit,</p> <p>(Evidenca nr. 58 Përmbledhëse e kapaciteteve të UAMD-së, Evidenca nr. 42.1 Ambiente të FSP, Evidenca nr. 101 Foto të laboratorëve).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se Standarti IV.2 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</i></p> <p><i>FSP zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e SHTM apo departamante të tjera të FSP.</i></p> <p><i>Laboratori i infermieristikës është i paisur me mulazhe që stimulojnë lindjen, ku studentët kryejnë dhe teknikat apo procedurat infermiore gjatë lindjes normale, manikina apo krahë mulazhi për injeksionet intravenoze dhe lloje të ndryshme kateteri, ku studentët mësojnë vendosjen e katetereve dhe kryerjen e injeksioneve venoze; ka elektrokardiogramën dhe aparatura e matjeve të shenjave vitale/monitor.</i></p> <p><i>Në funksion të programit të studimit në Bachelor në “Mami” është laborator i teknologjisë së Informacionit i cili është i pajisur me kompjutera dhe programe profesionale për që përdoren nga studentët pa pagesë për qëllim mësimi apo përgatitje të detyrave të kursit dhe/ose mikrotezës.</i></p>




	<p>e vjetëruar dhe shpesh herë bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët.</p> <p>Në takimin me stafin akademik u theksua se çdo vit akademik paraqiten kërkesa për tekste dhe literaturë mjekësore, por nuk është realizuar procedura e blerjes nga institucioni megjithëse çdo vit parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore.</p> <p>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me anë të një bashkëpunim më të mirë mes pedagogeve dhe stafit administrativ dhe drejtues të UAMD, për realizimin e procedurave të blerjes me qëllim pasurimin e mëtejshëm të fondit të bibliotekës.</p> <p>(Evidenca nr. 62 Raporti financiar UAMD)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD ka 3 biblioteka, një është pranë pranë Godinës në Currila që është biblioteka qendrore, biblioteka pranë Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit e cila është e vendosur në mjediset e godines A e ndodhur në Spitalle edhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Politiko Juriduke e vendosur në godinën B, Spitalle. Çdo bibliotekë ka hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Mjediset e bibliotekave kanë kapacitete në tituj dhe pajisje si kompjutera për të mundësuar plotësimin e kërkesave të tyre. Numri i titujve fizikë në fond është 12000, numri i teksteve mësimore 2500, artikujt shkencorë mbi 4000 dhe librat elektronikë mbi 30. 000. Ambientet e bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë.</p> <p>(Evidenca Nr.48 Informacione për bibliotekën UAMD, Vizita e ambienteve)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e Universitetit dhe ajo në fakultetet është e paisur me tekste universitare, libra e revista në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo ka nje fond fizik të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, libra apo revista shkencore, libra elektronikë, por të pakët në funksion të këtij programi studimi. <i>Megjithatë GVJ rekomandon që ajo duhet të pasurohet më tej me botime te fundit dhe me tituj të rinj në fushën e shkencave mjekësore.</i></p> <p>(Evidenca Nr.48 Informacione per biblioteken UAMD, Evidenca nr. 51 Manual biblioteke online, Vizita e ambienteve)</p>

<p>përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>këto në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen dhe nevojave të studentëve. Studentët pajisen me kartë regjistrimi, Institucioni ka planifikuar gjithashtu pajisjen me karta elektronike.</p> <p>(Nr.55 Kalendar i bibliotekës në fundjavë)</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>UAMD planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekste vijnë nga departamente e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e teksteve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat. Në takime me stafin akademik dhe në RVB theksohet se megjithëse çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore, në shumicën e rasteve këto fonde nuk janë realizuar dhe nuk janë zbatuar nga institucioni.</p> <p>(Evidenca nr. 50 Lista e Teksteve në Bibliotekë për Programin e Studimit, Evidenca nr. 62 Raport financiar UAMD)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ gjykon se Standarti IV.3 përmbushet kryesisht.</p> <p><i>UAMD ka 3 biblioteka, një është pranë pranë Godinës në Currila që është biblioteka qendrore, biblioteka pranë Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Edukimit e cila është e vendosur në mjediset e godines A e ndodhur në Spitalle edhe biblioteka e Fakultetit të Shkencave Politiko-Juriduke e vendosur në godinën B, Spitalle.</i></p> <p><i>Oraret e shërbimit të bibliotekës ofroheshin sipas një kalendarit të miratuar dhe të afishuar në ambientet e bibliotekës.</i></p>

<p>diplomim në programin e studimit.</p>	<p>menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Studentët e regjistruar pajisen me librezë studenti.</p> <p>Sekretaria mësimor ka në formë shkresore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Regjistrin themeltar të studentëve • Regjistrin me të dhënat akademike • Regjistrin e lëshimit të diplomave <p>Regjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p>Sekretaria mësimore arkivon :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dosjet e pranimit dhe regjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës • Proçes verbalet e testime në provime . • Dosjet e diplomimit; • Dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçes verbalet e notave të provimit/temave të diplomës • listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra. <p>Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore, dekani i fakultetit. Të gjitha opsionet e mundëshme janë të përcaktuar në manualin e përdorimit të sistemit UMS nga secili prej përfitueve të tij .</p> <p>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD-së, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP, Evidenca nr. 9 Rregullore e DSHTM, Evidenca nr. 13 Rregullore e Sektorit te Teknologjisë së Informacionit)</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativë të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullores përkatëse. Stafi akademik</p>

	<p>në kohë reale të dhëna në lidhje me të drejtën për të hyrë ose jo në provim, prenotimin e provimit, informacionit në lidhje me vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë semestrit, vlerësimin në provim dhe notën përfundimtare.</p> <p>(Vizita në institucion, Evidenca nr. 32 Sistemi Pitagora (Rash), Evidenca nr. 100 Njoftimet në rrjete sociale të FSP, Evidenca nr. 131 Njoftime me e-mail për Studentet e mamisë, Evidenca nr. 13 Rregullore e Sektorit të Teknologjise se Informacionit).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit e raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultate etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UAMD, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga UAMD dhe fakultete, stafin akademik, programet dhe sylabuset e lëndëve, bazën ligjore që funksionin UAMD, fakultetet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në secilin departament, strukturën e vitit akademik, orari mësimor etj. Portali i UAMD-së shërben si një platformë ku studenti mund të marrë informacion në websit-et e pedagogëve për materiale të ndryshme në lidhje me lëndë specifike. Çdo pedagog është i detyruar të vendosë në eëbsitin e tij një formë të përmbledhur të ciklit të leksioneve të lëndës së tij si edhe informacione që ai i vlerëson të rëndësishme për t'i komunikuar me studentet. Faqja zyrtare në web është në 2 gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.</p> <p>(Evidenca nr. 31 Print screen faqja e UAMD-së)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se Standarti IV.4 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>UAMD disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe</i></p>

<p>nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Fondet burojnë nga buxheti i shtetit, të ardhurat e universitetit nga shërbimet që UAMD ofron për aktorë të tretë si dhe tarifat e studentëve. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në çdo fillim viti akademik.</p> <p>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD-së, Evidenca nr. 62 Raport financiar i UAMD, Evidenca nr. 63 Plani Financiar Vjetor i Fakultetit të Studimeve Profesionale, Evidenca nr. 67 Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit të studimit; plani për mbështetje financiare për një cikël të plotë studimi.)</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Çdo vit akademik FSP në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifat e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifat e shkollimit për çdo program bazuar në VKM 638 datë 22.07.2015. Tarifat e shkollimit nuk e kalojnë koston e programit të studimit. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grante e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese. Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga MARSH dhe kontrolli i lartë i shtetit. Auditi vlerëson aktivitetin financiar të institucionit. GVJ gjeti kopje të Auditimit të UAMD.</p> <p>Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit i cili është i aksesueshëm dhe në faqën zyrtare të institucionit www.uamd.edu.al. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacion për të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare (grante, projekte) për studentët ose ndarjen e burimeve financiare për çdo vit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet.</p>

	<i>ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe grantin që mer nga MARSH të ardhurat nga shërbimet që kryhen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Fakulteti i SP, kanë hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Satutin e UAMD, rregulloret e FSP dhe rregulloret e Departamentit i SHMT dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedurat e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Mami”, si edhe sipas Udhezimeve të Ministrisë së Arsimit. Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen web të universitetit.


	<p>kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome.</p> <p>Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen web të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Në takimin me studentët, GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e zyrës së këshillimit të karrierës, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. Në statut dhe rregulloren e departamentit përcaktohen procedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit. Institucioni ka parashikuar dhe kuota për regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara.</p> <p>(Evidenca nr. 110 Kriteret e pranimit në DSHTM Evidenca nr. 5 Rregullore UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UAMD dhe FSP kanë në traditën e tyre organizimin e ditëve të hapura informuese në të cilat, prindër dhe gjimnazistë nga gjimnazet e qarkut të Durrësit dhe të qarqeve fqinje (të cilët janë burimi kryesor i studentëve që frekuentojnë këtë unuversitet) të cilët janë të interesuar për programet e studimit informohen nga pedagogë dhe studentë. Këto aktivitete organizohen zakonisht në periudhën mars – maj dhe kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriteret e përgjithshme dhe specifike për t’u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen web të UAMD.</p> <p>(Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 22 Strategjia e komunikimit UAMD)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UAMD parashikon kuota te posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidateve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, këto kriteret dhe kuota bëhen publike përpara çdo viti akademik.</p> <p>(Evidenca nr. 21 Rregullore e studentëve me aftësi të kufizuar)</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e</p>	<p>Pas diskutimit me drejtuesit dhe në bazë të dokumentacionit, UAMD dhe Departamenti harton dhe publikon përpara cdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur srudimet. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS. Kuotat e</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuset, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregulloret është përcaktuar shkalla e frekuentimit të detyruar për programin e studimit:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Frekuentimi i leksioneve, si rregull, është fakultativ. Në përputhje me specifikat e veta, në rregulloren e brendshme të programve të studimit mund të përcaktohen lëndë, frekuentimi i leksioneve të cilave mund të jetë i detyrueshëm deri në masën 80%;2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%;3. Frekuentimi i laboratoreve është i detyrueshëm në masën 100%. Kur studenti nuk ka frekuentuar deri në 25% të laboratorëve të çdo lënde, i shlyen ato në dy javët e fundit të vitit në vazhdim, apo semestrit kur lënda është semestrale. Kur studenti ka frekuentuar më pak se 75% të tyre, i shlyen ato në vitin pasardhës;4. Frekuentimi i praktikave profesionale /mesimore/ spitalore është i detyrueshëm në masën 100%. Në këtë program studimi nuk parashikohet kushtezim midis lendeve. Në sekretarinë mesimore të FSP mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mësimor nga studentët e çdo grupi mësimor, i cili plotësohet për çdo orë mesimore. Në rregullore përcaktohen gjithashtu kriteret dhe procedurat për kalimin nga njëri vit në tjetrin;5. Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 20 kredite të vitit të parë. 2. Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 20 kredite nga viti i dytë dhe jo më pak se 40 kredite nga viti i parë. 3. Studenti, i cili nuk plotëson kushtet për të kaluar në vitin pasardhës konsiderohet përsëritës i vitit akademik;
	<p>(Evidenca nr. 8 Rregullorja e FSP, Evidenca nr. 5 Rregullorja e UAMD, Evidenca nr. 9 Rregullorja e DSHTM, Evidenca nr. 10 Rregullorja e programit të studimit,</p>

	<p>transparencën e vlerësimit. Ata përdorin dhe procedurat e rishikimit të vlerësimit.</p> <p>(Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 10 Rregullore programit të studimeve, Evidenca nr. 109 Kërkesë Studenti për Rishikim Provimi dhe Ankimim Rezultati)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Institucioni ka përgatitur dhe një manual instruktues për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>Në rregullore përcaktohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diplomimi bëhet me provim përfundimtar ose temë diplome <ol style="list-style-type: none"> 1. Për provimin përfundimtar të formimit rregullorja përcakton procedurën e informimit të studentëve për temat e provimit, procedurën e hartimit të tezës, elementët e tezës, procedurën e vlerësimit, ankimimit dhe rivlerësimit. 2. Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës. - Kushtet që duhet të përmbushë student për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. <p>GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës).</p> <p>Nëse do të diplomohet me provim përfundimtar, studentët njoftohen të paktën tre muaj përpara përfundimit të semestrit të dytë mbi lëndët që do të përfshihen në provimin final, së bashku me peshën specifike dhe pikët përkatëse të çdo lënde, si dhe sqarohen mbi çdo paqartësi që mund të kenë mbi provimin përfundimtar të diplomimit. Në fillim të vitit të fundit të studimeve, njësia bazë në bazë të suksesit së dy viteve të para përcakton studentët të cilët mund të mbyllin studimet me temë diplome.</p> <p>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD, Evidenca nr. 5 Rregullore e UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca Nr.97 Rregullore e Mikrotezës në Fakulteti i Studimeve Profesionale, Evidenca nr. 111 Memo për Ngritjen e Komisionit të Provimit Final të Diplomimit, Evidenca 112 Njoftim i Sekretarisë për Provimin Final të Diplomimit)</p>



Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët që ndjekin programet mësimore Bachelor në “Mami” informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes Sekretarise Mësimore dhe webit ato gjejnë:</p> <ul style="list-style-type: none">– Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit– Informacion për objektivat formuese të programit– Strukturën dhe organizimin e programit– Planin mësimor– Syllabuset– Rregulloren– Suplementin e diplomës <p>(Evidenca nr. 4 Statuti UAMD, Evidenca nr. 5 Rregullore UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP)</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Në këtë dokumentacion studenti gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studenti orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimit (leksion, seminar, praktikë). Studenti i merr të dhënat nga faqja web e Institucionit.</p> <p>(Evidenca Nr.121 Dosja e programit të studimit (kurikula , plani mësimor, dhe personeli akademik; Evidenca Nr.124 Syllabuset Mami v.a. 2020-2021; Evidenca Nr.124 Syllabuset Mami v.a. 2019-2020).</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve për mundësitë e punësimit. Institucioni ka lidhje të ngushta me operatorët mjekësorë dhe me Urdhërin e Infermierit, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Zyra ALUMNI. Institucioni ka mundur të përfshirjen e studenteve në një sërë aktivitetesh informuese në lidhje</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 85

	<i>filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimet, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profillin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Në sekretarinë mësimore të FSP janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për cdo program studimi. Sekretaria ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Regjistrin themeltar të studentëve - Regjistrin e lëshimit të diplomave - Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave) <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Gjithashtu Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studenteve dhe disponon të dhëna të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit.</p> <p>(Evidenca nr. 70 analiza vjetore e FSP, Evidenca nr. 130 Të dhëna të plota të programit për regjistrimin, ecurinë, diplomimin, nota mesatare në hyrje dhe në dalje)</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të çregjistrimit. Këto të dhëna ruhen edhe në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: www.ascal.al

Faqe 87

të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	(Evidenca nr. 5 Rregullore UAMD, Evidenca nr. 8 Rregullore FSP, Evidenca nr. 70 Analiza Vjetore e Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore – Shkencore dhe aktiviteve të FSP)			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri profesionale.</p> <p>Në takimin me personelin akademik dhe drejtuesit e FSP, GVJ kërkoi informacion mbi licensimin dhe punësimin e studentëve të programeve të studimit të FSP. GVJ u informua se kalueshmëria në provimin e licensimit është mbi 90% në nivel fakulteti. Gjatë takimeve u deklarua që kërkesa të shtuara për punësim ka edhe jashtë Shqipërisë. Zyra së Alumni realizon skedimin i informacionit për punësimin.</p> <p>(Evidenca nr. 70 Analiza Vjetore e Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore – Shkencore dhe aktiviteve të FSP).</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ gjykon se Standarti V.4 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Në sekretarinë mësimore të FSP janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për cdo program studimi.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</i></p> <p><i>Të dhënat statistikore të studenteve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit nga dy struktura përkatëse. Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike.</i></p> <p><i>IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhëri i profesionisteve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



<p>rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>ekuivalentimit të elementëve të studimit. Në takimin me studentët ata vlerësoan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies.</p> <p>Studentët gjykojnë se praktikat në laboratorët simulatorë dhe praktikat profesionale në spitalet rajonale i pregatisin mjaft mirë për tregun e punës.</p> <p>Raportin teori-praktikë e vlerësojnë shumë të mirë. Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmash. Këshilli studentor i cili funksion në bazë të një rregullore, është organizmi ku studentët debatojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSP për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Koordinator kujdeset për përfshirjen e studenteve në procesin e rishikimit të kurrikulës, megjithatë GVJ evidenton që gjatë nuk ka ndryshime të kurrikulës gjatë viteve të fundit. Pyetësorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit të tyre.</p> <p>Pyetësori zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14- të. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme. Rezultatet e vlerësimit bëhen transparentë dhe i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësave të departamentit, si dhe dekanit nga DKSC në Rektorat. Në dokumentacion por dhe në takimin me studentët u evidentua përfshirja e tyre në përmirësimin e raportit teori-praktikë në lëndën mami.</p> <p>(Evidenca nr. 4 Statuti i UAMD-së, Evidenca nr.5 Rregullore e UAMD-së, Evidenca nr. 8 Rregullore e FSP, Evidenca nr. 78 Modele për Vlerësimin e Performancës së Pedagogut, 106 Pyetësor i vlerësimit të pedagogut, Evidenca nr. 108 Transparenca e Rezultateve të Anketimeve të Studenteve)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB.</p> <p>Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit.</p>

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>FSPka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Zyra e Karrierës dhe ALUMNI. – Sekretaria mësimore; është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim. – Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë – Zyra e Marrëdhënieve me jashtë – Zyra e IT. <p>Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve rubrikën e transparencës dhe Zyra e Karrierës realizon informimin e studenteve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim.</p> <p>Njëkohësisht Zyra e Karrierës ka si funksion parësor të saj ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe internship-e për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> <p>(Evidenca nr. 39 Shoqata Alumni UAMD, Evidenca nr. 41 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës, Evidenca nr. 84 Udhëzues nga zyra karrierës – aplikim pune)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1 është funksional dhe i përshtatshëm. Studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët.</p> <p>(Evidenca nr. 87 Memo mbi Mentorimet e Studentëve, Evidenca nr. 41 Aktivitetet e Zyrës së Karrierës, Evidenca nr. 84 Udhëzues nga zyra karrierës – aplikim pune)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar</p>	<p>Në institucion funksionon Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë – Identifikimin e burimeve për pozicione të vecanta pune – Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V				X
--	--	--	--	---

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një process i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. UAMD në strategjinë e zhvillimit institucional 2020-2025 një vënd të rëndësishëm i kushton zhvillimit të metodave inovative të mësimdhënies me qendër studentin duke pomovuar mendimin kritik, dialogun student pedagog dhe përgatitjen e studentëve të aftë për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se UAMD ka hartuar një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, zhvillimit të leksioneve të hapura nga lektorë të ftuar jashtë universitetit, vizitat studimore ej.</p> <p>(Evidenca Nr.43 Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve).</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, në nivel të Fakulteti dhe kordinatorin në nivel programi studimi përgjegjës për cilësinë i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. Kështu pranë UAMD - është ngritur dhe funksionon NJSBC në bazë të Rregullore se NJSBC ku përshkruhet si funksionin dhe bashkërendojnë punën njësia qendrore me njësitë në çdo fakultet dhe kordinatorët pranë çdo programi.</p>

publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë. Me tej strukturat pergjegjese hartojnë (institucioni) një raport në përmbyllje të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të UAMD. Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar ne Ligjin e Arsimit te Larte Nr. 80/2015, date 22.07.2015, Neni 103: "Sigurimi i Brendshem i Cilësisë".</p> <p>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, Evidenca nr. 106 raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull).</p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>GVJ vlerëson së të dhënat në raportin përfundimtar janë përshkruese në terma sasore dhe analitike si dhe me adresim të problematikave të hasura dhe rekomandimet për masa konkrete.</p> <p>Këto të dhëna i shërbejnë promovimit të prktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësimtë mësimdhënies si përcaktim e kriterëve dhe afateb]ve për rishikim të kurikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin eteknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj.</p> <p>(Evidenca nr. 11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD)</p>
Konkluzione	<p><i>GVJ gjykon se Standarti VI.1 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, në nivel të Fakulteti dhe kordinatorin në nivel programi studimi i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit.</i></p> <p><i>UAMD ka hartuar një udhëzues të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Studentëve u sanksionohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe ne komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti.</i></p> <p><i>Të dhënat në raportin përfundimtar të NJSBC janë përshkruese në terma sasore dhe analitike si dhe me adresim të problematikave të hasura dhe rekomandimet për masa konkrete.</i></p>



<p>funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sektorët mbulojnë të gjitha problematikat nga licensimi ne akreditim. NJSBC e bazon aktivitetin e saj në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015 - Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018) - Statuti i Institucionit - Vendimet e senatit, urdhërat e brendshëm, plani i punës <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit</p> <p>NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve. NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele. Bashkërendon gjithashtu procesin ndërmjet njësive në nivel institucional. - Monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në njësitë bazë. - Administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. <p>NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë.</p> <p>(Evidenca nr.11 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAMD i është nënshtruar procesit te akreditimit institucional dy herë, duke marrë një akreditim prej 5 vite në vitin 2016 dhe 4 vite në akreditimin e dytë në vitin 2022. GVJ në bazë të dokumentacionit dhe takimit me përfuqësuesit e NJSBC evidenton që institucioni përdor mekanizma të tillë si pyetësorët e vlerësimit të studentëve, vlerësimit të anëtareve të stafit akademik, vetëvlerësimit të pedagogeve, vlerësimin e infrastrukturës.</p> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të UAMD dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Metodatat të cilat aplikohen janë : pyetësorët për studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin, leksione të hapura, intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës etj.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë,</p>	<p>Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike UAMD ka përcaktuar dhe</p>

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>FSP përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike.</p> <p>Disa nga instrumentat e vetëvlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Analiza vjetore e departamentit – Vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik – Pyetsori i studentëve për cilësinë e programit mësimor e mësimdhënien, infrastrukturën dhe vlerësimi i stafit akademik. <p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të parë të studimeve, të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të FSP në përputhje me standardet si dhe të monitoroj punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL.</p> <p>Në përmbushjen e këtyre qëllimeve në RVB dhe gjatë diskutimeve me drejtuesit, një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSP ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL.</p> <p>NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të UAMD-së, ku ka informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptimin e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj. Procesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit të studimit kryhet kryesisht mbi bazën e veprimtarive të përgjithshme dhe në funksion të cilësisë. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të</p>

<p>studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i studentëve frekuentues - Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikëve - Plotësimi i standarteve të grupeve mësimore - Plotësimi i standarteve të stafit akademik - Plotësimi i standarteve të didaktikës dhe laboratorëve - Kalueshmëria dhe cilësia semestrare - Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale - Numri i të diplomuarve - Kalueshmëria në provimin e shtetit - Konkluzionet e pyetsorit të studentëve <p>NJSBC mban kontakte me institucionet kombëtare, me urdhërin e Infermierit për të vlerësuar rezultatet e studentëve në provimin e licensimit. Kanë kaluar provimin e shtetit dhe janë licesuar si infermier mami 78% e studentëve të diplomuar pranë UAMD në vitin 2020. 85% të studentëve në vitin 2021.</p> <p>(Takimi me stafin drejtues të FSP, NJSBC)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave</p>	<p>Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim ze informacioni i përpunuar nga zyra e këshillimit të karrierës dhe alumni për punësimin e studentëve.</p> <p>Përmes kësaj zyre po realizohet “gjurmimi” i studentëve që kanë përfunduar më parë këto programe studimi për evidentimin e pozicioneve të punësimit apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. metoda të tjera janë sondazhe me studentët aktual që ndjekin programin e studimit bachelor “MAMI” por dhe studentët e diplomuar dhe të punësuar, nëpërmjet kontakteve që gjenden në databazën e zyrës së Alumni.</p> <p>Këto sondazhe shërbejnë për të vlerësuar si mirëpritën studentët në tregun e punës dhe si vlerësohet aftësia që ata kanë fituar nga programi i studimit dhe integrimi i tyre në tregun aktual. Institucioni informohet në mënyrë periodike për rezultatet e studentëve në provimin e licencës. Pasi përpunohen të dhënat, rezultatet bëhen publike nëpërmjet një raportit të shkruar apo dhe takimeve të hapura me stafin akademik të njësisë kryesore më qëllim evidentimin e problematikave të hasura dhe mundësitë për</p>

<p>e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>me institucione ndërkombëtare në mënyrë që programi i studimit të njihet sa më lehtë në vëndet e huaja dhe/ose realizimin e diplomave të dyfishta. në funksion të saj prioritare mbetet zhvillimi i programeve mësimore në gjuhën angleze, rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare, por edhe rekrutimi i studentëve të huaj. Gjithashtu, në vëmendjen e Institucionit do të jetë edhe ndërkombëtarizimi i doktoraturave, nëpërmjet forcimit të dimensionit ndërkombëtar, të bashkëpunimit efektiv në nivel shkencor me Universitetet e huaja, përfshirjes në projekte ndërkombëtare pasi kërkimi shkencor po bëhet gjithmonë e më shumë i hapur dhe i ndarë me të gjithë.</p> <p>Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor do të realizohen nëpërmjet zhvillim të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve. Sfida e sotme nuk lidhet me informimin e studentit të painformuar, por me formimin e studentit të informuar. Kjo kushtëzon: leksione që dalin edhe nga kërkimi i drejtpërdrejtë; përfshirjen e studentit në projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogun e të drejtuara prej tij; shndërrimin shkallë-shkallë të raportit “pedagog-student” në “udhëheqës-kërkues”, sidomos në nivelin master e doktorature. Për përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit, institucioni ka përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në hartimin e politikave të zhvillimit strategjik dhe në politikat e ndërmarra për ndërkombëtarizimin e programit të studimit.</p> <p>(Evidenca Nr.06 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Evidenca Nr.19 Strategji nderkombetarizimi UAMD 2019-2021)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSP, Përgjegjësit e Departamenteve të SHMT, Përfaqësues të Stafit Akademik, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit është konceptuar si Përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:</p>

<p>në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Procedura e vlerësimit të brendshëm I nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UAMD. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget cdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve.</p> <p>(Evidenca Nr.29 Kodi i etikës i UAMD)</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p><i>Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit Bachelor në "Mami" është përfshirë dhe një ekspert i jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon.</i></p> <p>Në procesin e vlerësimit instucioni realizon takime me ish të diplomuar, mjekë specialiste, eksperte të DSHP të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmisimin e programit të studimit dhe lidhjen më efikase me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ gjykon se Standarti VI.4 përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 2020-2025 të UAMD përfshin politikat që do të ndërmerren për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me konventën europiane, planin e ndërkombëtarizimit të UAMD.</i></p> <p><i>NJSBC funksionon në nivel institucioni UAMD, Fakulteti dhe njësie baze e cila koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.</i></p> <p><i>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Mami", njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjese për programin e studimit, siç është Personelit akademik, ndihmes akademik e administrativ, dhe sigurisht të studentëve.</i></p> <p><i>Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor do realizohen nëpërmjet zhvillim të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve.</i></p>

<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike. Këto raporte krahas rezultateve kanë dhe rekomandimet përkatëse apo adresim të problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se FSP dhe departamenti i Shkencave Mjekesore teknike kanë zhvilluar një sërë aktivitete me studentët dhe stafin akademik për informimin, aftësimin e tyre për zgjidhje të situatave të ndryshme në praktikën klinike, aktivitete kërkimore shkencore, konferenca shkencore e studentëve dhe stafit akademik në funksion të sigurimit dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Vlen të theksohet dhe mbështetja e institucionit për stafin akademik për rritjen e tyre profesionale si pjesëmarrjen në aktivitet shkencore apo pagimi i Fee për botime në revista me faktor impakti apo Scope.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se Standarti VI.5 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit.</i></p> <p><i>NJSBCB realizon pyetësorët institucional në fund të cdo semestri , të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Raporti i monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studenteve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individeve dhe merren masa korigjuese përkatëse.</i></p> <p><i>Raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike. Këto raporte krahas rezultateve kanë dhe</i></p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Mami” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Pika të forta

1. Infrastruktura fizike e UMAD, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit si dhe infrastruktura në dispozicion të programit të studimit për realizimin e praktikës mësimore, ku kryhen procedurat infermierore mami qw i shërbejnë aftësitë profesionale të studentëve.
2. Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Mami” është hartuar bazuar në modelet kombëtare dhe Europiane për profesionet e rregulluara, duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore në fuqi.
3. Staf akademik i kualifikuar dhe me eksperiencë në mësimdhënie për implementimin e programit të studimit.
4. Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i eksperiencës me institucione të Arsimit të Lartë Europiane të studentëve dhe pedagogëve të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi (“Auxila Academie”, Marrëveshja e bashkëpunimit me “Hungarian Hospice Palliative Association etj) si dhe një sërë projektesh ndërkombëtare në funksion të mobilitetit dhe kërkimit shkencor. (ENTRAL, QUADIC, KALCEA, STAND, IDEA, ENGINE, U-SIA, MEPM, TTO4FOOD, Value- X, CBHE Erasmus +) dhe i projektit VITECH ku UAMD është lider)
5. Marrëveshjet e bashkëpunimit që ka UMAD me institucione shëndetësore publike dhe jo publike për realizimin e praktikës profesionale të studentëve, realizimi i temave të diplomës apo kërkimit shkencor si dhe krijimi i kontakteve për punësimin në vazhdimësi pasi disa prej bashkëpunëtorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë.
6. Mbështetja financiare nga institucioni e stafit akademik për kërkimin shkencor nëpërmjet parashikimit çdo vit të një buxheti të veçantë, si dhe administrimi i të ardhurave të siguruara nga aktivitete të ndryshme nga departmenti.
7. Sigurimi i fondeve financiare për kërkimin shkencor jo vetëm nga burime të brendshme të institucionit, por edhe nga burime të jashtme përmes pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare të njësisë bazë/departamenti.
8. Përfshirja në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit të një eksperti të jashtëm nga institucionet bashkëpunuese.

Pika të dobëta

1. Numri i lartë i stafit akademik me kontaktë në implementimin e programit mesimor (raporti PAE/PAK është 15/52 duke mos qenë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
2. Mungesa e teksteve mësimore në shumicën e lëndëve të këtij programi studimi. Pjesa më e madhe e lëndëve bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët,



function of education and scientific research (ENTRAL, QUADIC, KALCEA, STAND, IDEA, ENGINE, U-SIA, MEPM, TTO4FOOD, Value- X, CBHE Erasmus +) and VITECH in which UAMD is the leader).

5. Cooperation agreements of UAMD has with public and non-public health institutions for the realization of the professional practice of students, the realization of diploma topics or scientific research, as well as the creation of contacts for continued employment since some of the collaborators are direct employers.
6. Involvement in the internal evaluation process of the study program of an external expert from the cooperating institutions.
7. Financial support from the institution of the academic staff for scientific research through the provision of a special budget each year as well as the administration of the income provided by different activities from the department.
8. Providing financial funds for scientific research not only from internal sources of the institution but also from external sources through participation in international projects of the base unit/department.

Weaknesses:

1. The high number of academic staff with contracts in the implementation of the educational program (the ratio ASE/ASC varies from 15/52) which does not comply with the legal acts in force.
2. The lack of text books in most of the subjects of this study program. Most of the subjects in this study program are based on written lectures by themselves lecturers, the textbooks in some subjects are outdated. The mandatory and recommended literature in the syllabus is outdated.
4. Despite the high number of titles, the medical literature was poor in titles and outdated.

RECOMMENDATIONS

1. Recruitment of effective academic staff based on the legal acts in force and review of workload distribution in accordance with the field of expertise
2. Drafting basic teaching texts in the Albanian language and updating the basic and recommended literature.
3. Review of subject holders and adjustment of their category according to legal requirements.
4. Enriching the library fund with medical literature of recent years and with new titles in the field of medical sciences, through a better cooperation between academic staff and the administrative and management staff of UAMD, for the realization of the purchase procedures.

